

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

MARRËVESHJE E MIRËRKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

PER FINANCIMIN E PROJEKTIT – “NDERTIMI I KOMPLEKSIT MEMORIAL NË  
FSHATIN RETIJË- RAHOVEC”  
NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës - përfaqësuar nga Drejtori  
Bislim ZOGAJ  
dhe

Komunës së Rahovecit-përfaqësuar nga Smajl Latifi - Kryetar i Komunës

Neni 1  
Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, përfaqësuar nga Drejtori Bislim Zogaj, dhe në mes të Komunës së Rahovecit, përfaqësuar nga Ismajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit, me qëllim të financimit të projektit të përbashkët me titull:

“Ndërtimi i Kompleksit Memorial në Fshatin Retijë- Rahovec”

Neni 2  
Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

Projekti për “Ndërtimi i Kompleksit Memorial në Fshatin Retijë- Rahovec” në Komunën e Rahovecit”, Për këtë projekt AMKMK do të ndaj nga kodit për intervenimeve emergjencave 14657, të paraparë sipas planit buxhetor të Agjencisë. Projekti në total kap vlerën prej 11,847.66

- 2.1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës financon këtë projekt në vlerë prej 10,000.00 Euro për vitin 2021.
- 2.2. Komuna e Rahovecit financon këtë projekt në vlerën prej 1,847.66 Euro, për vitin 2021

Neni 3  
Obligimet e Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

- 3.1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës zoton mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e sjellë në Komunë të Rahovecit për realizimin e kontratës, sipas Marrëveshjes.
- 3.2. Pagesa për financimin e projektit “Ndërtimi i Kompleksit Memorial në Fshatin Retijë- Rahovec” nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do të bëhet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të organit mbikëqyrës dhe Menagjerit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Rahovecit.
- 3.3 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale mundet të cakton një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit “Ndërtimi i Kompleksit Memorial në Fshatin Retijë- Rahovec” i cili do të raportojë Agjencisë.
- 3.4 Pas përfundimit të projektit, ky investim do të regjistrohet në SIMFK si aset i komunës së Rahovecit.

Neni 4  
Obligimet e Komunës

- 4.1. Komuna e Rahovecit obligohet që për projektin e “Ndërtimi i Kompleksit Memorial në Fshatin Retijë- Rahovec” të zhvilloj procedurat e prokurimit për procesin e tenderimit, vlerësimin dhe dhënies së kontratës.

4.3. Komuna emëron Menaxherin/ Organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

4.4. Komuna është e obliguar të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për rrjedhat e realizimit të projektit.

Neni 5  
Kohëzgjatja e Marrëveshjes

5.1. Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Komuna e Rahovecit përfundon me përfundimin e projektit.

Neni 6  
Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes

6.1. Të gjitha palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësi në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike.

6.2. Me pëlqim të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës kjo marrëveshje mundë të ndryshohet dhe të plotësohet.

Neni 7


Kjo marrëveshje partneriteti është përpiluar në 4 ekzemplarë identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

Neni 8  
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj


PALËT NË MARRËVESHIJE


Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

  
Bislim ZOGAJ  
Drejtor



Komuna e Rahovecit

  
Smajlë Adifi  
Kryetar i Komunës



Datë: 21/05/2021  
Rahovec